



REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIMIN E KUADRIT LIGJOR PËR NDOTJEN AKUSTIKE



Përgatiti
Dr. Irena Dule

Ky publikim u realizua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e autorit dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.



Funded by
the European Union

Treguesi i lëndës

I.	Hyrje.....	3
II.	Direktiva të Bashkimit Evropian.....	4
III.	Legjislacioni Shqiptar për ndotjen akustike	5
	3.1. Vështrim i përgjithshëm i legjislacionit	5
	3.2. Transporti si burim zhurmash	7
	3.3. Industria si burim i zhurmave	8
	3.4. Legjislacioni për monitorimin e zhurmave	9
IV.	Planet Vendore	12
V.	Gjetje & Rekomandime.....	13
VI.	Bibliografia	17

I. Hyrje

Ky dokument u hartua nga konsulentja ligjore, av. Irena Dule, si produkt kontraktor për shoqatën “Lëvizja Ecovolis”, në kuadër të zbatimit të projektit të financuar nga CoPlan për ndotjen akustike.

Efekti negativ që sjell zhurma është më shumë se një shqetësim i thjeshtë. Në nivele dhe kohëzgjatje të caktuara ekspozimi ndaj zhurmës mund të shkaktojë dëmtim fizik të daullës së veshit dhe qelizave të ndjeshme të veshit të brendshëm dhe të rezultojë në humbje të përkohshme ose të përhershme të dëgjimit, e njohur si humbje dëgjimi e shkaktuar nga zhurma. Humbja e dëgjimit zakonisht ndodh për shumicën e njerëzve të ekspozuar në mënyrë të përsëritur ndaj më shumë se 105 dBA. Këta persona do të kenë deri në njëfarë mase humbje të përhershme të dëgjimit. Përveç shkakut të humbjes së dëgjimit, ekspozimi i tepërt i zhurmës mund të rrisë presionin e gjakut dhe pulsën, të shkaktojë nervozizëm, ankth dhe lodhje mendore dhe të cenojë gjumin, rekreacionin dhe komunikimin personal. Fëmijët që jetojnë në zona me nivele të larta të ndotjes akustike mund të vuajnë nga stresi dhe probleme të tjera, të tilla si dëmtime në hapësirën e kujtesës dhe vëmendjes.¹ Prandaj, kontrolli i ndotjes akustike është i rëndësishëm në vendin e punës dhe në komunitet. Ndotja akustike gjithashtu ndikon në jetën e egër. Një gamë e gjerë kafshësh, duke përfshirë insektet, bretkosat, zogjtë dhe lakuriqtë e natës, mbështeten te tingujt për një sërë arsyesh. Ndotja akustike mund të ndërhyjë në aftësinë e një kafshe për të tërhequr një partner, për të komunikuar, për të lundruar, për të gjetur ushqim ose për të shmangur grabitqarët dhe kështu mund të jetë edhe një kërcënim ekzistencial për organizmat vulnerabël.²

Sipas monitorimit, për vitin 2011 dhe 2014 të evidentuar në Vlerësimin Strategjik Mjedisor për Planin e Përgjithshëm Kombëtar, Raporti Final, 2016 tregohet se Shqipëria qëndron afër vendeve të para në Evropë me parametra të lartë të ndotjes nga zhurma urbane. Si vlerat mesatare të ditës ashtu dhe ato të natës e tejkalojnë standardin e legjisllacionit të BE-së dhe atë shqiptar. Në vecanti, vlerat mesatare të zhurmës gjatë ditës dhe natës në qytetet e monitoruara janë përkatësisht LAeq 63 dB (A) dhe LAeq 49.1 dB (A). Të dy vlerat e tejkalojnë standardin e legjisllacionit të BE-së dhe atë Shqiptar (LAeq/Ditën 55 dB (A) dhe LAeq/Natën 45 dB (A)).

Për të gjitha arsyet më sipër me qëllim zbutjen e efekteve negative të ndotjes akustike miratohen rregulla e ligje, si në nivel kombëtar, ashtu edhe në nivel vendor. Në vende të ndryshme janë zhvilluar akte të kontrollit të zhurmave industriale (njihen si akte të sigurisë dhe shëndetit në punë)³, të cilat vendosin kriteret e zhurmës industriale në mënyrë që të ofrojnë kufizime në intensitetin e ekspozimit ndaj zërit dhe në kohëzgjatjen për të cilën mund të lejohet ai intensitet, ose akte të kontrollit të ndotjes akustike në qytet, përmes të cilave vendosen standarde minimale të ndërtimit të banesave, apo ndërtimet me barriera të autostradave, për të bërë ndarjen e autostradës nga zonat e banuara ngjitur, etj.

Dokumenti në vazhdim trajton se si rregullohet ndotja akustike në vendin tonë, duke e parë me sy kritik këtë legjisllacion, me qëllim për të dalë me disa rekomandime, të cilat mund të

¹ *Jerry A. Nathanson* *Richard E. Berg* *Ndotja Akustike*, gjendet në linkun: <https://www.britannica.com/science/noise-pollution>

² Id

³ Në SHBA, “Akti i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë”, 1970

përdoren nga aktivistët mjedisore apo aktorë vendimarrës që janë të angazhuar për të përmirësuar këtë aspekt të të drejtave mjedisore në legjislacionin shqiptar

II. Direktiva të Bashkimit Evropian

Edhe pse ende jo në cilësinë e një shteti anëtar, Shqipëria ka detyrimin e përshtatjes me *aquis comunitaries*, dhe detyrimin e transpozimit të Direktivave të BE-së, përfshirë edhe ato që rendisim në vijim për efekt të këtij dokumenti.

Paraprakisht, edhe nga vlerësimi i bërë legjislacionit të zhurmave, këto direktiva nuk janë transpozuar ende në pjesën më të madhe të tyre.

- **Direktiva 2002/49/EC e Parlamentit Evropian, 25 Qershor 2002, “Për zhurmat”.**

Sipas kësaj direktive, hartimi i planit të veprimit për menaxhimin mjedisor të zhurmave është një detyrim i shteteve anëtare të BE-së, të cilat duhet të hartojnë planet e menaxhimit për vendet e tyre dhe të përgatisin hartat e zhurmës. Pas përgatitjes së planeve kombëtare, direktiva parashikon dhe përcakton afate të hartimit të planeve lokale të zhurmave.

Direktiva parashikon dhe një sërë kërkesash bazë që duhet të përmbajë plani kombëtar i veprimit për një vend.

Direktiva për zhurmat e gjeneruara nga sektori i transportit rrugor, kërkon që plani i veprimit për administrimin mjedisor të zhurmave nga ky sektor të përmbushë një sërë objektivash, siç janë:

- Identifikimi i zonave me efekte më të theksuara të zhurmave dhe popullsia e ekspozuar nga këto pika;
- Identifikimi i pikave ku janë ndërtesa të ndjeshme (spitale, shkolla, çerdhe, kopshte etj.);
- Përcaktimi dhe vlerësimi i masave për reduktimin e zhurmave që shkaktojnë shqetësime ndaj popullsisë;
- Përcaktimi i kostove të nevojshme për këto ndërhyrje.

- **Direktiva 2002/30/EC e Parlamentit Evropian, 26 Mars 2002, “Mbi krijimin e rregullave dhe procedurave në raport me prezantimin e operacioneve që prodhojnë zhurmë në Aeroporte”.**

Kjo direktivë parashikon një sërë masash që duhen ndërmarrë për të administruar dhe kontrolluar nivelin e zhurmave në mjedis, që lidhen me:

- masat që duhet të ndërmarrin vendet anëtare për të reduktuar zhurmat dhe numrin e njerëzve të ekspozuar ndaj zhurmave të shkaktuara nga trafiku ajror;
- vlerësimin e grupeve të interesit dhe të kërkesave të tyre që janë nën ndikimin apo mund të ndikohen nga zhurmat e shkaktuara nga trafiku ajror;
- ndërmarrjen e masave të domosdoshme nga vendet anëtare për të minimizuar dhe reduktuar efektet negative të shkaktuara nga zhurmat në mjedis nga trafiku ajror.

Sa më sipër përbëjnë objektivat kryesorë të kësaj direktive, arritja e të cilëve kërkon të ndërmerren masa konkrete dhe të monitoriohet implementimi i tyre në vazhdimësi.

- **Direktiva 2000/14/EC e Parlamentit Evropian, 8 Maj 2000, “Për përafrimin e ligjeve të shteteve anëtare lidhur me emetimin e zhurmës në mjedis nga pajisjet për përdorim të jashtëm”.**

Përgjithësisht direktiva përcakton pajisjet që janë objekt i kësaj direktive, nivelet e lejuara të zhurmave nga secila pajisje.

Kjo direktivë përmban rreth 56 pajisje që i nënshtrohen rregullave dhe që duhet të përmbushin kërkesat për nivelet e lejuara të zhurmave që ato gjenerojnë. Në këtë grup pajisjesh përfshihen:

- gjeneratorët e tipave dhe madhësive të ndryshme;
 - pajisjet e shpimit të betoneve, asfaltit (matrapik, çekiçët pneumatikë, trapan, etj.);
 - pajisje të prerjes së metaleve dhe drurëve (sharrat, zmerilues, etj.);
 - pajisjet e presimit, vibrimit, rulimit;
 - eskalatorët, vinçat, etj.
- **Direktiva 2003/10/KE, 6 Shkurt 2003, “Për kërkesat minimale të shëndetit dhe sigurisë në lidhje me ekspozimin e punonjësve ndaj risqeve që krijohen nga agjentët fizikë (zhurma)”.**

Kjo direktivë është transpozuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr .842, datë 03.12.2014, “Për miratimin e rregullores “Për mbrojtjen e sigurisë dhe shëndetit të punëmarrësve nga risqet e lidhura me zhurmën në vendin e punës”

III. Legjislacioni Shqiptar për ndotjen akustike

3.1. Vështrim i përgjithshëm i legjislacionit

Zhurmat janë pjesë e rregulloreve kombëtare dhe atyre lokale, të cilat kanë për qëllim të kjojnë masa për mbrojtjen nga zhurmat.

Si element i mjedisit, zhurmat janë pjesë e tij, ndaj edhe legjislacioni për mjedisin parashikon një sërë rregullash për mbrojtjen e mjedisit nga ky element fizik. Në nenin 38 të ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, jepet përkufizimi i mbrojtjes nga zhurmat:

“Mbrojtja nga zhurmat dhe dridhjet përfshin masat e mbrojtjes nga zhurmat dhe dridhjet, ndaj të cilave njerëzit janë të ekspozuar, në veçanti në zona të banuara, në parqe publike apo në zona të tjera të qeta në zona urbane, në zona të qeta në zona rurale, pranë shkollave, spitaleve, si dhe pranë ndërtesave e zonave të tjera të ndjeshme ndaj zhurmave dhe/ose dridhjeve.

Mbrojtja nga zhurmat dhe masat ndaj tyre përcaktohen edhe në pjesë të veçanta të legjislacionit, ku mund të përmendim: legjislacioni për zhvillimin urban, legjislacioni që mbulon përdorimin e pajisjeve industriale që gjenerojnë zhurmë.

Me rëndësi në këtë drejtim, është edhe ligji kuadër i miratuar për të siguruar administrimin e mirë të zhurmave. Ligji nr. 9774, datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në Shqipëri” parashikon ngritjen e Këshillit Teknik për Zhurmat (KTZH) pranë Ministrisë së Mjedisit, si organizëm ndërinstitucional këshillimor, në nivel qendror, përgjegjës për politikën dhe bashkërendimin e tyre për administrimin e zhurmave. Ndërsa janë organet e qeverisjes vendore që brenda juridiksionit të tyre kanë kompetenca të:

- Drejtojnë hartimin dhe zbatimin e planeve vendore të veprimit për zhurmën, të cilat miratohen nga këshillat e bashkive/komunave;
- Drejtojnë procesin e hartëzimit të zhurmës.

Në vështrim të ligjeve të sipërpërmendura parashikohen disa rregulla të posacme për menaxhimin e zhurmave si më poshtë:

- Ministria e Mjedisit është përgjegjëse për certifikimin e ekspertëve të zhurmës në mjedis;
- Monitorimi i zhurmës në mjedis realizohet si pjesë e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit;
- Leja e mjedisit që jepet për aktivitete me ndikim në mjedis përcakton kushtet që duhet të respektojnë personat fizikë dhe juridikë gjatë aktivitetit të tyre;
- Planet e zhvillimit duhet të përfshijnë gjithashtu masat për mbrojtjen kundër zhurmave. Këto masa synojnë mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, të përcaktuara në përputhje me këtë ligj dhe në legjislacionin e posaçëm.⁴
- Çdo ndërtim dhe rikonstruksion ndërtesash, për banim apo për veprimtari të tjera ekonomike e shoqërore, projektohet dhe realizohet në mënyrë që zhurma në brendësi apo në afërsi të saj, të jetë brenda nivelit kufi. Ndryshimi i destinacionit të përdorimit të ndërtesës shoqërohet me masa mbrojtëse nga zhurma, për respektimin e vlerës kufi.

Përveç ligjeve të sipërpërmenduar, edhe ligje të tjerë të veçantë përmbajnë dispozita për mbrojtjen nga ndotja që shkaktojnë zhurmat. Kështu, ligji nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, në nenin 5 parashikon se:

“Mbetjet menaxhohen duke mos vënë në rrezik shëndetin e njeriut, duke mos përdorur procese ose metoda që mund ta dëmtojnë atë ose mjedisin dhe sidomos duke mos shkaktuar shqetësime përmes zhurmave ose erërave, në përputhje me përcaktimet e akteve të tjera ligjore apo nënligjore.”

Në respektim të detyrimit për miratimin e një Plani Kombëtar të menaxhimit të zhurmave, ky Plan është miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 123, datë 17.02.2011, “Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Menaxhimin e Zhurmave në Mjedis”, në të cilin janë trajtuar burimet e zhurmave që vijnë nga aktivitetet e mëposhtëme:

- Transporti;

⁴ Neni 23 ligji nr. 10431, datë 09.06.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”

- Aktivitetet e shërbimit social që gjenerojnë zhurma nëpërmjet muzikës (bare, restorante, pabe, disko);
- Makineritë dhe pajisjet e ndryshme në ambientet e jashtme.

Më poshtë jepet një analizë e gjetjeve të këtij Plan Veprimi dhe problematikave të tjera që vijnë nga legjislacioni në fuqi.

3.2. Transporti si burim zhurmash

Transporti rrugor

Sa i takon zhurmave që vijnë nga transporti, duhet thënë që në fillim se në vendin tonë këto zhurma krijohen më së shumti nga transporti rrugor dhe më pak nga ai ajror dhe hekurudhor, për shkak se aktivitetin më të madh në vend i përket atij të transportit rrugor.

Kuadri ligjor që rregullon transportin rrugor përbëhet nga aktet e mëposhtme:

- Ligji nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 07.04.2000 “Rregullore për zbatimin e Kodit Rrugor”;
- Udhëzimi i Ministrisë të Transporteve dhe Telekomunikacionit nr. 3413, datë 16.07.2003 “Mbi kontrollin teknik të mjeteve rrugore”, ndryshuar me udhëzimin nr. 6371, datë 17.02.2004 “Rregullore e sigurimit teknik”.
- Udhëzimi nr.6, dt.12.11.2021 të Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë, për afruar plotësisht me Direktivën 2014/45/BE, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 3 prill 2014 “*Mbi kontrollin teknik periodik të automjeteve dhe rimorkiove të tyre, dhe që shfuqizon Direktivën 2009/40/KE*”

Nga analiza e kuadrit ligjor vihet re nevoja për ndryshime ligjore që lidhet me monitorimin e zhurmave në mjedis dhe përcaktimi i indikatorëve dhe burimeve që gjenerojnë zhurmë që duhet të jenë pjesë e procesit të monitorimit.

Në Kodin Rrugor ka një parashikim të përgjithshëm për kufizimin e zhurmave kur krijimi i zhurmave vjen nga mënyra e dhënies së mjetit. Ky parashikim, përveçse është i pashoqëruar me masa administrative, i referohet vetëm situatës kur shkaktimi i zhurmës vjen nga keqdrejtimi i mjetit dhe jo situatave të tjera, si për shembull: ndalimi i rënies së borisë, etj. Në këtë drejtim, në Kodin Rrugor duhet të bëhen ndërhyrje për kërkesa specifike për rregullat e qarkullimit rrugor sa u takon zhurmave në mjedis. Për këtë qëllim është e domosdoshme parashikimi i ndërhyrjeve në sinjalistikën rrugore dhe përfshirja në të e sinjaleve që lidhen me zhurmat, si dhe vendosjen e këtyre sinjaleve në pika të caktuara.

Administrimi i zhurmave në mjedis, sa i takon sektorit të transportit, është i lidhur me ministrinë përgjegjëse për sektorin e transportit dhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Transportit Rrugor. Këto institucione janë përgjegjëse për iniciativat ligjore, të cilat nga ana e tyre duhet të sigurojnë për afrimin me Direktivën Evropiane nr. 2002/49/EC, (e trajtuar më sipër) “Për nivelet e lejuara të zhurmave në mjedis nga mjetet e transportit, si dhe të organizimit dhe funksionimit të sistemit të kontrollit, kolaudimit dhe të sinjalistikës rrugore për zhurmat në mjedis”.

Transporti ajror

Sa i takon transportit ajror, ky rregullohet nga Kodi Ajror i miratuar në vitin 2020. Ky ligj ka parashikuar disa rregulla lidhur me ndotjen nga zhurmat. Konkretisht, në nenin 65, Kodi përcakton detyrime për ministrin përgjegjës për transportin ajror. Së pari, ai, në bashkëpunim me ministrin që mbulon çështjet e mjedisit, harton politika të veçanta për mbrojtjen e mjedisit dhe mbrojtjen nga zhurmat, si dhe rregulloren që përmban standardet dhe përgjegjësitë e operatorit të aeroportit për respektimin e tyre. Së dyti, në bazë të kërkesës së operatorit të aeroportit, ministri miraton masa të përkohshme dhe përjashtime që lejojnë operimin e avionëve civilë, të cilët ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në mjedis.

Ky kod për herë të parë ka parashikuar një organ përgjegjës dhe rregulla për zhurmat nga operimi i avionëve. Kështu, Autoriteti i Aviacionit Civil (AAC) është organi përgjegjës për garantimin e standardeve për zhurmat e krijuara nga operimi i avionëve.

Rregullat për kërkesat, vlerësimin, përjashtimet dhe kufizimet operative, të lidhura me zhurmat e krijuara nga operimi i avionëve, përcaktohen me rregullore të përbashkët të ministrit përgjegjës për transportin ajror dhe ministrit që mbulon çështjet e mjedisit, në përputhje me detyrimet ndërkombëtare.

AAC-ja i kërkon operatorit të aerodromit të ndërtojë e të mirëmbajë pajisje në aerodrom apo në afërsi të tij për matjen konstante të zhurmave të emetuara nga avionët që ulen dhe ngrihen, kur lëvizjet e trafikut ajror vjetor kalojnë shifrën 50 000 (pesëdhjetë mijë) operime. Matjet u komunikohen rregullisht AAC-së dhe çdo autoriteti tjetër publik të interesuar.

Në mënyrë që ky Kod të jetë i zbatueshëm, është e rëndësishme që të miratohen aktet nënligjore që autorizon ky ligj. Këto akte nuk janë miratuar ende dhe mbeten të jenë pjesë e monitorimeve të ardhshme.

3.3. Industria si burim i zhurmave

Nga analiza e kuadrit ligjor rregullator që lidhet me konformitetin e pajisjeve industriale, shihet se jo gjithmonë ka kërkesa specifike për pajisjet që gjenerojnë zhurmë. Ky kuadër ligjor rregullator përmban:

- Ligj nr. 9779, datë 17.07.2007 “Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore”;
- Ligj nr. 9290, datë 07.10.2004 “Për produktet e ndërtimit”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 723, datë 05.11.2004 “Për procedurat dhe rregullat bazë të funksionimit të organizmit të autorizuar për kryerjen e vlerësimit të konformitetit”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 842, datë 03.12.2014 “Për miratimin e rregullores “Për mbrojtjen e sigurisë dhe shëndetit të punëmarrësve nga risqet e lidhura me zhurmën në vendin e punës”.

Legjislacioni shqiptar parashikon kërkesa specifike për konformitetin, për materialet e ndërtimit, si dhe për pajisjet nën presion, por jo për pajisje të sektorëve të tjerë. Nisur nga kjo është e nevojshme që:

- Ministria përkatëse për tregtinë duhet të përcaktojë kërkesat minimale që duhet të përmbushin pajisjet që gjenerojnë zhurmë dhe janë listuar në direktivën nr. 2000/14 EC, (të cilën e trajtuam më sipër);
- Krijimi i strukturave të posacme për monitorimin e nivelit të zhurmave të gjeneruara nga këto pajisje;
- Kontrollimi i zbatimit të kërkesave ligjore nga përdoruesit e këtyre mjeteve, për të përdorur mënyra dhe metoda për minimizimin e nivelit të zhurmave nga këto pajisje.

Gjeneratorët përbëjnë pjesën më problematike të emetimit të zhurmave në mjedis. Si rezultat i problematikës së konstatuar në furnizimin me energji elektrike dhe për të siguruar një vazhdimësi në furnizim me energji, shumë subjekte si: restorante, hotele, disko, lojëra fati, institucione etj., kanë instaluar gjeneratorë të madhësive të ndryshme për prodhim energjie.

Në zbatim të kërkesave të direktivës së sipërcituar, duhet që makineritë që gjenerojnë zhurmë të pajisen me një certifikatë të prodhuesit, e cila duhet të përmbajë dhe nivelin e zhurmave që ato gjenerojnë. Po ashtu, këto pajisje duhet të përmbajnë një informacion minimal që ka të bëjë me konformitetin e pajisjes, siç janë:

- emri dhe adresa e prodhuesit të pajisjes;
- një përshkrim i përgjithshëm i pajisjes;
- emri tregtar;
- tipi, seria, numri;
- të dhëna teknike të pajisjes për identifikimin dhe vlerësimin e zhurmave nga këto pajisje dhe nëse është e nevojshme, përshkrim skematik apo narrativ të këtyre karakteristikave;
- referencat ndaj direktivës përkatëse;
- një raport teknik mbi mënyrën e vlerësimit të zhurmave, në përputhje me kushtet e parashikuara në direktivë;
- instrumentet teknike të përdorura për matjen e zhurmës dhe rezultatet e marra.

Këto janë të dhëna minimale që duhet të shoqërojnë çdo pajisje, e cila është përfshirë në këtë listë.

3.4. Legjislacioni për monitorimin e zhurmave

Monitorimi i zhurmave është detyrim ligjor që duhet të jetë pjesë e skemës kombëtare të monitorimit të mjedisit. Në funksion të kësaj janë miratuar edhe disa akte nënligjore si Udhëzimi i Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, nr. 2, datë 07.01.2012 “Për treguesit, mënyrat e vlerësimit, rregullat dhe kërkesat teknike e metodike për vlerësimin e nivelit të zhurmës, si dhe për verifikimin e ndërhyrjeve të bëra për zgjidhjen dhe përmirësimin e gjendjes”; Udhëzuesi i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes Sociale “Për monitorimin e zhurmave dhe efekteve në shëndet”⁵.

Sa i takon kompetencës për monitorimin vihet re se ka një mungesë koherence të rregullimeve ligjore në dy akte të ndryshme. Nga njëra anë ligji nr. 9774, datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis” përcakton se kompetetnca për monitorimin e zhurmave, si element mjedisor, i takon Agjencisë Kombëtare të Mjedisit. Nga

⁵ Miratuar me Urdhër nr. 234 datë 25.05.2015 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

ana tjetër, VKM nr. 1189 datë 18.11.2009, “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit”, në Aneksin 1, pika 3, gërma “ë” përcakton se institucioni përgjegjës për monitorimin e zhurmave është Instituti i Shëndetit Publik.

Në praktikë, është Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit që ka ushtruar këtë kompetencë⁶ edhe pse jo në mënyrë të rregullt. Në këto rrethana është e rekomandueshme të korrigohet Vendimi i Këshillit të Ministrave, jo vetëm sepse ky është akt më i ulët në hierarkinë e akteve, por edhe sepse zhurma është dhe duhet të trajtohet si element mjedisor dhe përgjegjëse për monitorimin e të cilës është Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

Në një audit të kryer nga Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) në vitin 2019, mbi ndotjen akustike, rezultuan disa problematika të shoqëruara me rekomandime si më poshtë:

Së pari, u vlerësua se Raportet e Gjendjes së Mjedisit në vitet 2016 dhe 2017, duke qenë se nuk janë në koherencë me Programet Kombëtare të Monitorimit të Mjedisit, sa i përket kapitullit të monitorimit të zhurmave dhe më specifikisht frekuencës dhe numrit të pikave të monitorimit, ka cënuar vlerësimin real të nivelit të zhurmave mjedisore. Gjithashtu në raportin e auditimit vihet re se në Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit dhe në Raportin e Gjendjes së Mjedisit⁷ për vitet 2016 dhe 2017, nuk përshkruhet mënyra e përzgjedhjes së pikave të monitorimit dhe nuk merren parasysh zonat akustike, si për shembull në rastin e praktikës së Serbisë. Metodologjia e monitorimit të zhurmave sipas praktikës së Serbisë përcakton matjet në një numër të ndryshëm të vendndodhjeve të pikave të monitorimit dhe në kohë të ndryshme të ditës dhe natës. Numri i pikave të monitorimit varion nga 3 në 40 për zona të ndryshme në të cilat matet zhurma dhe ato janë të përcaktuara në bazë të gjashtë zonave akustike si më poshtë:

- zona rekreative, spitalore dhe rehabilituese, vende kulturore dhe historike, parqe të mëdha;
- zona turistike dhe fshatra të vegjël, kampe dhe zona shkollore;
- zona banimi;
- zona biznesi, zona tregtare dhe rezidenciale dhe terrene të lojërave;
- qendra e qyteteve, zonat administrative me ndërtesa, autostrada përgjatë zonës, autostrada dhe rrugë të qytetit;
- zona industriale, depo, shërbime dhe terminale të transportit pa ndërtesa banimi

Përzgjedhja e pikave të monitorimit, duke marrë në konsideratë të gjashtë zonat akustike, ndihmon dhe rrit më shumë vërtetësinë e të dhënave që dalin nga monitorimi i zhurmave për qytetet.

Së dyti, Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Mjedisit dhe Ministrisë së Shëndetësisë nr. 8, datë 27.11.2007 "Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara", në tabelën shoqëruese përcakton kufijtë e zhurmave të lejuara dhe përcakton se matjet bëhen nga një ekspert

⁶ Shih raportin e KLSH “Për ndotjen akustike”, 2019, në linkun: <https://panel.klsh.org.al/storage/phpM4tYFo.pdf>

⁷ "Raporti i Gjendjes së Mjedisit" është dokumenti i përgatitur çdo vit nga AKM, në përputhje me Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit. Në këtë raport paraqiten, komentohen dhe analizohen treguesit mjedisorë (përfshirë edhe zhurmat) si dhe jepen rekomandimet për përmirësimin e gjendjes së tyre.

zhurmash. Nga raporti i KLSH-së, vihet re se raportohet për mungesë të një ekspertize të tillë dhe mungesë në organikën e strukturave përkatëse të kontrollit të zhurmave.

Së treti, KLSH i rekomandon Ministrisë së Shëndetësisë të marrë masa për ndryshimin e “Udhëzuesit për monitorimin e zhurmave dhe efekteve në shëndet” (miratuar me Urdhër nr. 234 datë 25.05.2015), në përputhje me praktikën zvicerane, e cila përmbledhet në aktin e KLSH-së si më poshtë:

“Udhëzimi mbi matjen e emetimit të zhurmave” nga Kantoni Ticino në Zvicër.

Departamentit të Territorit, Sektorit të mbrojtjes së ajrit, ujit dhe tokës në Kantonin Ticino (Zvicër) i është besuar detyra e përgatitjes së Udhëzuesit për matjen dhe protokollimin e emetimeve të zhurmës nga trafiku rrugor dhe jo vetëm. Në këtë Udhëzues, krahas përshkrimit të metodologjisë për monitorimin e transportit rrugor, jepet një tablo më e qartë mbi strukturën legislative aktuale (si ligji zviceran dhe ai italian mbi zhurmat, si dhe Direktiva e BE-së 2002/49/EC, e njohur si Direktiva e zhurmave mjedisore), projektet, standardet dhe referencat bibliografike në të cilën mbështetet ky udhëzues, si dhe shembuj nga zbatimi në praktikë i udhëzuesit.

Gjithashtu rekomandohet që në “Udhëzuesin për monitorimin e zhurmave dhe efekteve në shëndet”, miratuar me urdhër nr. 234 datë 25.05.2015 nga MSHMS, në kapitullin “Metodologjia e matjeve të zhurmave në rrugë” nuk përcaktohet saktë frekuenca ose kohëzgjatja në të cilën duhet bërë monitorimi i zhurmave në një pikë monitorimi.

Frekuenca ose kohëzgjatja sa i përket numrit të ditëve që duhet bërë monitorimi i zhurmave në një pikë monitorimi duhet të përcaktohet saktë në “Udhëzuesin për monitorimin e zhurmave dhe efekteve në shëndet” dhe të jetë disa ditë në stinë.

Së katërti, pjesë e monitorimit është edhe vetëmonitorimi i operatorëve privatë që gjenerojnë zhurma në mjedis, të cilët para ushtrimit të aktivitetit të tyre duhet të pajisen me leje mjedisore të tipit C, dhe të kryejnë vetëmonitorimet sipas kushteve të vendosura në lejen mjedisore. “Leje mjedisi e tipit C” është leja e miratuar nga Agjencia Rajonale e Mjedisit dhe e lëshuar nga QKB, që i jep të drejtën e funksionimit, tërësisht ose pjesërisht, instalimit të tipit C dhe që përmban të shkruara kushtet e nevojshme për të garantuar se instalimi përmbush kërkesat e këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi. Ndërkohë, sipas ligjit nr. 9774, datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, vetëmonitorimi i zhurmës në mjedis realizohet nga ekspertë të certifikuar dhe përballohet nga personat fizikë e juridikë, të cilëve u përkasin veprimtaritë, instalimet dhe burimet e zhurmës që monitorohen. Aktualisht në Shqipëri raportet e vetëmonitorimit për subjektet që zotërojnë leje mjedisore për zhurmat kryhen nga ekspertë mjedisorë që disponojnë laboratorë të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit. Këto vetëmonitorime duhet të dorëzohen në kohën e duhur në ARM-në përkatëse, brenda afateve të përcaktuara. Sipas raportit të KLSH-së, ky detyrim nuk plotësohet nga të gjithë operatorët.

Së pesti, sipas raportit të KLSH-së, sistemi i monitorimit nuk është gjithëpërfshirës dhe prezantues për të gjetur mesataren e një qyteti të caktuar. Frekuenca ose matja në pikat e monitorimit në vetëm 1 ose 2 ditë në vit nuk mund të nxjerrë rezultate për gjendjen reale të zhurmave gjatë një viti. Për të dalë në këtë konkluzion jemi mbështetur në praktikën zvicerane

të përmendur më sipër, në të cilën theksohet se frekuenca e monitorimit të zhurmave duhet të jetë disa ditë në stinë.

Së gjashti, mos ruajtja e të dhënave në arkiv, nga matjet e kryera në pikat e monitorimit, mund të ndikojë në humbjen e rezultateve dhe gjetjeve nga matjet e kryera gjatë viteve.

Në funksion të menaxhimit të zhurmave në mjedis janë miratuar edhe Urdhëri i Përbashkët i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nr. 58, datë 18.12.2017 "Për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e situatës lidhur me zbatimin e kërkesave ligjore për manaxhimin e zhurmave në mjedis" dhe Udhëzimi nr. 1 i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit datë 07.01.2012 "Për kërkesat minimale për hartëzimin strategjik të zhurmave", Udhëzimi i Ministrisë së Mjedisit nr. 1, datë 19.01.2018 "Për miratimin e kërkesave minimale për hartimi e planeve të veprimit për zhurmat". Vihet re se aktet nënligjore, si në titull dhe në përmbajtje, riciklohen pa sjellë asnjë ndryshim. Gjithashtu, nga përmbajtja e dy udhëzimeve të fundit vërehet se parashikimet janë tejet të përgjithshme dhe jo detyruese. Në teknikë, akte të tilla i ngjajnë më shumë programeve apo dokumenteve politikë se sa akteve rregulluese administrative.

IV. Planet Vendore

Gjithashtu, në nivel vendor, këshillat e njësive të qeverisjes vendore kanë detyrimin ligjor të miratojnë planet vendore për zhurmat, kërkesë kjo që buron nga neni 8 i ligjit për administrimin e zhurmave në mjedis.

Bashkia Tiranë është në proces të hartimit të planit vendor për zhurmat, i cili kaloi edhe një proces të konsultimit publik në fund të vitit 2021.

Ky plan, dhe në parim të gjitha planet vendore, duhet të adresojnë disa probleme si:

- Realizimin e hartëzimit të zhurmave për qytetin e Tiranës;
- Shpalljen e zonave të qeta në territorin që ajo administron;
- Vendosijen e sinjalistikës së nevojshme për kufizimin/ndalimin e përdorimit të borive;
- Vendosijen e kriterëve për përdorimin e materialeve të izolimit akustik në lejet e ndërtimit;
- Mbledhjen e të dhënave mbi numrin e popullsisë së ekspozuar ndaj zhurmave, në territorin e Bashkisë;
- Në formularët e aplikimit dhe në lejet e ndërtimit që Bashkia miraton duhet të jenë të përcaktuara oraret në të cilat duhet të kryhen punimet e ndërtimit nga subjektet që përfitojnë leje ndërtimi. Mos vendosja e orareve të caktuara se kur duhet të kryhen punimet, bën që në mjaft raste të punohet në orët e vona të natës duke sjellë shqetësim për banorët. Mos përcaktimi i orareve të punimit në lejet e ndërtimit, sjell pamundësi nga ana e inspektorëve vendorë për marrjen e masave administrative për subjektet që ndërtojnë natën.
- Materialet e izolimit akustik janë shumë të rëndësishme sa i përket reduktimit të zhurmave mjedisore në ambientet e brendshme të banimit. Bashkia duhet të vendosë kriterë fikse për subjektet/kompanitë e ndërtimit mbi llojet e materialeve izolues-akustikë që duhet të përdorin, për të ndikuar në përmirësimin e cilësisë së godinave sa i përket reduktimit të zhurmave.

V. Gjetje & Rekomandime

Kuadri ligjor rregullator dhe institucional për administrimin mjedisor dhe të qendrueshëm të zhurmave në mjedis nuk është i plotë. Problematika e tij ka të bëjë me sa më poshtë:

1. Legjislacioni Shqiptar nuk është i përafuar plotësisht me Direktivat e BE për ndotjen akustike

Bashkimi Evropian ka miratuar disa direktiva në mbrojtjen e mjedisit nga zhurmat. Këto direktiva duhet të transpozohen në legjislacionin Shqiptar dhe konkretisht:

- Direktiva 2002/30/EC e Parlamentit Evropian, 26 Mars 2002 “Mbi krijimin e rregullave dhe procedurave në raport me prezantimin e operacioneve që prodhojnë zhurmë në Aeroporte”;
- Direktiva 2002/49/EC e Parlamentit Evropian, 25 Qershor 2002 “Për zhurmat”;
- Direktiva 2000/14/EC e Parlamentit Evropian, 8 Maj 2000 “Për përafrimin e ligjeve të shteteve anëtare, lidhur me emetimin e zhurmës në mjedis nga pajisjet për përdorim të jashtëm”.

2. Vihet re mbivendosje të akteve ligjore dhe nënligjore

Në legjislacionin që adreson problemet e zhurmave vihen re mbivendosje.

Ligji nr. 9774, datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis” përcakton se kompetenca për monitorimin e zhurmave, si element mjedisor, i takon Agjencisë Kombëtare të Mjedisit. Nga ana tjetër, VKM nr. 1189 datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit”, në Aneksin 1, pika 3, gërma “ë” përcakton se institucioni përgjegjës për monitorimin e zhurmave është Instituti i Shëndetit Publik.

Në praktikë është Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit që ka ushtruar këtë kompetencë edhe pse jo në mënyrë të rregullt. Në këto rrethana është e rekomandueshme korrigjimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave, jo vetëm sepse ky është akt më i ulët në hierarkinë e akteve, por edhe sepse zhurma është dhe duhet të trajtohet si element mjedisor dhe përgjegjëse për monitorimin e të cilës është Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

3. Plotësimin e kuadrit ligjor me akte nënligjore në zbatim të ligjit për zhurmat

Vihet re se përveç ligjeve që adresojnë problematikën e zhurmave, kuadrit ligjor i mungojnë

aktet nënligjore që e bëjnë të zbatueshëm legjislacionin. Për këtë rekomandojmë konkretisht:

- Të miratohen Vendimet e Këshillit të Ministrave të planifikuar, në fillim të vitit 2017, sipas Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Planin e Përgjithshëm Kombëtar, Raporti Final, 2016. Konkretisht:
 - VKM "Për kriteret, procedurat dhe rregullat për certifikim, pezullimin dhe heqjen e certifikatës së ekspertit të zhurmës në mjedis"
 - VKM "Për përbërjen dhe organizimin e Komitetit Teknik të Zhurmave (KTZH)"

Miratimi i këtyre dy akteve do të bëjnë të mundur përafrimin e legjislacionit Shqiptar plotësisht me Direktivën 2002/49 EC.

- Miratimin e një urdhëri rregullues në zbatim të kërkesave të Direktivës 2000/14/EC, lidhur me makineritë që gjenerojnë zhurmë, të cilat duhet të pajisen me një certifikatë të prodhuesit, e cila duhet të përmbajë dhe nivelin e zhurmave që ato gjenerojnë. Po ashtu, këto pajisje duhet të përmbajnë një informacion minimal, i cili ka të bëjë me konformitetin e pajisjes;
- Në Kodin Rrugor duhet të bëhen ndërhyrje për të kërkesa specifike për rregullat e qarkullimit rrugor sa u takon zhurmave në mjedis. Për këtë qëllim është e domosdoshme parashikimi i ndërhyrjeve në sinjalistikën rrugore dhe përfshirja në të e sinjaleve që lidhen me zhurmat, si dhe vendosjen e këtyre sinjaleve në pika të caktuara, apo ndalimi i situatave kur shkaktimi i zhurmës vjen nga rënia e borisë, etj.;
- Të hartohen aktet nënligjore të autorizuara nga Kodi Ajror, në mënyrë që ky i fundit të jetë plotësisht i zbatueshëm;
- Rekomandohet të parashikohen rregulla për krijimin e strukturave të posaçme për monitorimin e nivelit të zhurmave të krijuara nga pajisjet që gjenerojnë zhurmë në çdo sector industrial;
- Ndryshime ligjore rekomandohen të bëhen dhe në legjislacionin që lidhet me monitorimin e zhurmave në mjedis dhe përcaktimi i indikatorëve dhe burimeve që gjenerojnë zhurmë që duhet të jenë pjesë e procesit të monitorimit;
- Duhet të hartohen rregullore të veçanta për monitorimin e zhurmave, ekspertiza, pikat e monitorimit, etj;
- Rekomandohet të parashikohen rregulla lidhur me akreditimin e procesit të monitorimit dhe matjes së zhurmave dhe ruajtjen në arkivin e AKM-së të dhënat për zhurmat që rezultojnë nga matjet vjetore. Aktualisht këto të dhëna nuk arkivohen.

4. Realizimi i planeve vendore dhe hartëzimit të zhurmave nga bashkitë.

Jo të gjitha Bashkitë kanë miratuar Planin Vendor të Bashkive. Rekomandohet të monitorohen planet vendore të miratuara nëse ato përmbushin kërkesat e parashikuara në

Direktivat e BE-së. Në përgjithësi dhe në mënyrë të përmbledhur planet vendore duhet të adresojnë edhe çështjet si më poshtë:

- Realizimin e hartëzimit të zhurmave për qytet;
- Shpalljen e zonave të qeta në territorin që bashkia administron;
- Vendosjen e sinjalistikës së nevojshme për kufizimin/ndalimin e përdorimit të borive;
- Vendosjen e kriterëve për përdorimin e materialeve të izolimit akustik në lejet e ndërtimit;
- Mbledhjen e të dhënave mbi numrin e popullsisë së ekspozuar ndaj zhurmave, në territorin e Bashkisë;
- Në formularët e aplikimit dhe në lejet e ndërtimit që Bashkia miraton duhet të jenë të përcaktuara oraret në të cilat duhet të kryhen punimet e ndërtimit nga subjektet që përfitojnë leje ndërtimi. Mos vendosja e orareve të caktuara se kur duhet të kryhen punimet, bën që në mjaft raste të punohet në orët e vona të natës duke sjellë shqetësim për banorët. Mos përcaktimi i orareve të punimit në lejet e ndërtimit, sjell pamundësi nga ana e inspektorëve vendorë për marrjen e masave administrative për subjektet që ndërtojnë natën.
- Materialet e izolimit akustik janë shumë të rëndësishme sa i përket reduktimit të zhurmave mjedisore në ambientet e brendshme të banimit. Bashkia duhet të vendosë kriterë fikse për subjektet/kompanitë e ndërtimit mbi llojet e materialeve izolues-akustikë që duhet të përdorin për të ndikuar në përmirësimin e cilësisë së godinave sa i përket reduktimit të zhurmave.

5. Mungesa e miratimit të akteve nënligjore, dhe në ndonjë rast kur aktet nënligjore janë miratuar por janë jo efektive, e bëjnë edhe zbatimin e ligjit të pamundur

Sipas një kërkesë për informacion drejtuar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, lidhur me zbatimin e disa detyrimeve ligjore rezultoi se një pjesë e mirë dhe domethënëse e detyrimeve ligjore nuk janë zbatuar edhe pse ekzistojnë aty prej vitesh. Konkretisht:

- Në MTM nuk ka asnjë sektor/drejtori/specialist të profilizuar dhe përgjegjës lidhur me manaxhimin e ndotjes akustike, parashikuar në pikën 3 të nenit 2 të ligjit nr. 9774 datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”. Kjo bën të pamundur përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në dispozitat ligjore për uljen e impaktit negativ që zhurmat shkaktojnë në mjedis dhe shëndetin publik;
- Këshilli Teknik për Zhurmat i parashikuar sipas ligjit nr. 9774 datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis” nuk është ngritur dhe nuk ka funksionuar asnjëherë dhe kjo ndikon në mospërmbushjen e detyrimeve ligjore lidhur me zhurmat mjedisore;

- Ministri i Turizmit dhe Mjedisit, në bashkëpunim me Ministrinë e Energjisë dhe Infrastrukturës, nuk ka miratuar udhëzimin për rregullat teknike dhe masat e mbrojtjes nga zhurma që në fazën e projektimit dhe gjatë ndërtimit të ndërtesave;
- Ministri i Turizmit dhe Mjedisit, në bashkëpunim me Ministrinë e Energjisë dhe Infrastrukturës, nuk ka miratuar udhëzimin për kërkesat dhe rregullat e verifikimit akustik të ndërtesave, para se ato të vihen në përdorim;
- Mungon akti nënligjor për të miratuar formatin e regjistrit të zhurmës, si dokumenti bazë, ku pasqyrohen të dhënat dhe treguesit e saj, që rezultojnë nga monitorimi dhe matjet. Ky format ndihmon në ngritjen e një strukture funksionale informative mbi subjektet e pajisura me leje mjedisore, nga ku çdo person fizik dhe juridik hedh të dhënat për zhurmat që emetohen nga veprimtaria e tyre.
- Udhëzimi i Ministrit të Mjedisit nr 1, dt 19.01.2018, "Për miratimin e kërkesave minimale për hartimin e planeve të veprimit për zhurmat" nuk është zbatuar. Gjithashtu nga përmbajtja e Udhëzimit të dytë, i cili në një masë ka ricikluar Udhëzimin e parë, vërehet se parashikimet janë tejet të përgjithshme dhe jo detyruese (soft law). Nga pikpamja e teknikës legjislative, aktet nënligjore krijohen për të qenë sa më konkrete dhe zbatues, ndërsa këto akte i ngjajnë më shumë programeve apo dokumenteve politikë. Këto lloj aktesh në fakt nuk sjellin në mënyrë të drejtpërdrejtë një efekt negativ, por miratimi i këtij akti është një detyrim ligjor, që në dukje është respektuar, por në praktikë është jo efektiv.

6. Monitorimi i zbatimit të ligjit

Aktet nënligjore, edhe kur ato janë miratuar, nuk kanë qenë efektive. Për këtë aktet ligjore dhe nënligjore duhet të parashikojnë edhe mundësinë e monitorimit të tyre. Në mënyrë alternative ky monitorim mund të bëhet nga organizata të shoqërisë civile. Për shembull disa akte nënligjore që evidentohen në raportin e KLSH-së "Për ndotjen akustike" (2019), nuk kanë përmbushur objektivat e tyre, si:

- Urdhëri i Përbashkët i Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nr. 58, datë 18.12.2017 "Për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e situatës lidhur me zbatimin e kërkesave ligjore për manaxhimin e zhurmave në mjedis";
- Udhëzimi nr. 1 i Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, datë 07.01.2012 "Për kërkesat minimale për hartëzimin strategjik të zhurmave" nuk është vënë në zbatim. Hartëzimi i zhurmave nuk është bërë as në nivel kombëtar dhe as në nivel lokal. Hartat strategjike të zhurmave kanë si qëllim sigurimin e të dhënave lidhur me zhurmat, sigurimin e informacionit për qytetarët, si dhe për hartimin e planeve të veprimit.

7. Raporti i KLSH-së "Për ndotjen akustike" (2019), ka dhënë disa rekomandime të cilat duhet të vlerësohen nga administrata dhe vendimarrësit

Të merren masa për të adresuar problematikat e auditit të kryer nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në vitin 2019, mbi ndotjen akustike, ku ndër më të rëndësishmet janë:

- Raportet e Gjendjes së Mjedisit në vitet 2016 dhe 2017, duke qenë se nuk janë në koherencë me Programet Kombëtare të Monitorimit të Mjedisit, sa i përket kapitullit të monitorimit të zhurmave dhe më specifikisht frekuencës dhe numrit të pikave të monitorimit, ka cënuar vlerësimin real të nivelit të zhurmave mjedisore. Gjithashtu në raportin e auditimit vihet re se në Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit dhe në Raportin e Gjendjes së Mjedisit për vitet 2016 dhe 2017 nuk përshkruhet mënyra e përzgjedhjes së pikave të monitorimit dhe nuk merren parasysh zonat akustike si për shembull në rastin e praktikës së Serbisë. Përzgjedhja e pikave të monitorimit, duke marrë në konsideratë të gjashtë zonat akustike, ndihmon dhe rrit më shumë vërtetësinë e të dhënave që dalin nga monitorimi i zhurmave për qytetet.
- Udhëzimi i përbashkët i Ministrit të Mjedisit dhe Ministrit të Shëndetësisë nr. 8, datë 27.11.2007 "Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara", në tabelën shoqëruese përcakton kufijtë e zhurmave të lejuara dhe përcakton se matjet bëhen nga një ekspert zhurmash. Një ekspert i tillë mungon në organikën e strukturave përkatëse të kontrollit të zhurmave.
- Ministria e Shëndetësisë rekomandohet të marrë masa për ndryshimin e "Udhëzuesit për monitorimin e zhurmave dhe efekteve në shëndet", (miratuar me urdhër nr. 234 datë 25.05.2015) në përputhje me praktikën zvicerane.
- Mungojnë strukturat e certifikimit të nivelit të zhurmave në mjedis dhe vlerësimet konkrete të impaktit dhe problematikës me zhurmat në mjedis që kanë sektorët e transportit, industrisë, aktivitetet tregtare, pajisjet që gjenerojë zhurmë etj.
- Rekomandohet ngritja e seksionit të zhurmave në Institutin e Shëndetit Publik, si qendër reference kombëtare për problemet teknike të vlerësimit akustik të zhurmave dhe të efekteve në shëndet.

VI. Bibliografia

1. Direktiva 2000/14/EC e Parlamentit Evropian "Për përafrimin e ligjeve të shteteve anëtare lidhur me emetimin e zhurmës në mjedis nga pajisjet për përdorim të jashtëm".
2. Direktiva 2002/49/EC e Parlamentit Evropian "Për zhurmat".
3. Direktiva 2003/10/KE (26, 2003).
4. Direktiva 2002/30/EC "Mbi krijimin e rregullave dhe procedurave në raport me prezantimin e operacioneve që prodhojnë zhurmë në Aeroporte".
5. *Raport "Për ndotjen akustike"*, KLSH. (2019)
6. Ligj nr. 9779, datë 17.7.2007 "Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore".
7. Ligji nr. 9290, datë 7.10.2004 "Për produktet e ndërtimit".
8. Ligji nr. 96/2020 "Kodi ajror i Republikës së Shqipërisë".

9. Ligji nr. 9774, datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në Shqipëri”.
10. Ligji nr.10 431 datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”.
11. Ligji nr.10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.
12. Ligji nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”.
13. Ligji nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”.
14. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 123, datë 17.2.2011, “Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Menaxhimin e Zhurmave në Mjedisit”.
15. Vendim i Këshillit të Ministrave nr.723, datë 5.11.2004 “Për procedurat dhe rregullat bazë të funksionimit të organizmit të autorizuar për kryerjen e vlerësimit të konformitetit”.
16. Vendim nr. 842, datë 3.12.2014 “Për miratimin e rregullores “për mbrojtjen e sigurisëdhe shëndetit të punëmarrësve nga risqet e lidhura me zhurmën në vendin e punës”.
17. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.153, datë 7.4.2000 “Rregullore për zbatimin e Kodit Rrugor”.
18. VKM nr. 1189 datë 18.11.2009, “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit”.
19. Vlerësimi Strategjik Mjedisor për Planin e Përgjithshëm Kombëtar, Raporti Final, 2016
20. Udhëzimi i Ministrit të Mjedisit, nr 1, dt 19.01.2018, «Për miratimin e kërkesave minimale për hartimi e planeve të veprimit për zhurmat».
21. Udhëzimi i Ministrit të Transporteve dhe Telekomunikacionit nr.3413, datë 16.7.2003 “Mbi kontrollin teknik të mjeteve rrugore”, ndryshuar me udhëzimin nr.6371, datë 17.2.2004 “Rregullore e sigurimit teknik”.
22. Udhëzimi nr. 1 i Ministrisë së Mjedisit datë 07.01.2012 “Për kërkesat minimale për hartëzimin strategjik të zhurmave”.
23. Udhëzimi nr. 2, datë 07.01.2012 “Për treguesit, mënyrat e vlerësimit, rregullat dhe kërkesat teknike e metodike për vlerësimin e nivelit të zhurmës, si dhe për verifikimin e ndërhyrjeve të bëra për zgjidhjen dhe përmirësimin e gjendjes”.
24. Urdhër nr.234 datë 25.05.2015 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
25. Urdhëri i Përbashkët i Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me nr. 58, datë 18.12.2017, “Për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e situatës lidhur me zbatimin e kërkesave ligjore për manaxhimin e zhurmave.
26. Udhëzim i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës, nr. 6, datë 12.11.2021 "Mbi kontrollin teknik të mjeteve rrugore"

27. Akti i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë. (1970). ShBA.

28. Berg, J. A. (n.d.). *Ndotja Akustike*.

* * *

Tiranë, Janar 2022